

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**

**NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË  
ZBATIMIT**

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri Autoriteti Rrugor Shqiptar  
Adresa “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë  
Tel/Faks +355 4 2234487  
E-mail info@arrsh.gov.al  
Ueb-faqe www.arrsh.gov.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Eduart Agalliu  
E-mail eduart.agalliu@arrsh.gov.al

3. Lloji i procedurës së prokurimit: E Hapur - Mbi kufirin e lartë monetar - Punë publike - prokurim me mjete elektronike

4. Lloji i kontratës / Marrëveshjes kuadër: Realizimi i punimeve

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-28684-05-11-2022.

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Rehabilitimi i Segmentit Rrugor Fier - Vlorë (Rruga e Vjetër)”

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): - Punime ndërtimi për autostrada, rrugë\_45233100-0

8. Fondi limit: 833,288,437.25 (tetëqind e tridhjetë e tre milion e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e tridhjetë e shtatë presje njëzet e pesë) Lekë pa TVSH  
Në Euro: 6,908,949.82 EUR pa TVSH

9. Situata sipas parashikimeve të Nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë: Bazuar në Nenin 127 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” jemi në kushtet e modifikimit të kontratës sipas përcaktimit të këtij neni. Autoriteti Rrugor Shqiptar ka në zbatim kontratën Nr. 5510/5 prot, datë 29.07.2022 me objekt: “Rehabilitimi i Segmentit Rrugor Fier - Vlorë (Rruga e Vjetër)”, me REF-28684-05-11-2022.

- Vlera e kontratës është 792.055.250,40 Lekë (pa përfshirë vlerën e TVSH-së).

\*Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe e Operacioneve me shkresën Nr. 2153 prot, datë 26.03.2024, ka paraqitur relacionin teknik, në të cilin janë paraqitur dhe prezantuar të gjitha shkaqet që kanë çuar në nevojën për këtë modifikim kontrate.

\*Mbikëqyrësi i punimeve “S&L Studio” SHPK me shkresën Nr. extra prot, datë 27.01.2023 administruar pranë ARRSH-së me Nr. 805 prot, datë 27.01.2023 ka përcjellë propozimet e kontraktorit “COBIAL” SHPK në lidhje me ripunimin e objektit: “Rehabilitimi i Segmentit Rrugor Fier - Vlorë (Rruga e Vjetër)”

- ❖ Gjatë realizimit të punimeve, Kontraktori është ndeshur me kushte që kanë penguar zbatimin në kohë të kësaj kontrate. Konkretisht, në zonën e Novoselës po kryhen punime për ndërtimin e ujësjellësit nga një kompani tjetër për llogari të Bashkisë Vlorë. Punimet për ndërtimin e këtij ujësjellësi që priteshin të mbaronin në fund të vitit 2023 nuk kanë përfunduar ende, pasi kanë pësuar një shtyrje deri në fund të muajit Maj 2024.

Kjo problematikë është raportuar periodikisht nga Mbikëqyrësi i punimeve, kjo gjë ka sjellë si pasojë pezullimin e punimeve më datë 16.08.2023 dhe rifillimin e punimeve më datë 15.09.2023, raportuar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, konform Udhëzimit Nr. 2, datë 18.03.2022 “Mbi Raportimin e Zbatimit të Kontratës”. Aktualisht, punimet vijnë të pezulluara për arsyet e lartpërmendura.

Këto punime shtesë nuk mund të parashikoheshin që në projektim, për arsyet e mëposhtme:

1- Projekt zbatimi i rrugës se vjeter Fier-Vlore eshte hartuar nga shoqeria projektuese G & K ne vitin 2010. Ky projekt eshte miratuar ne Keshillin Teknik te ARRSH-se ne daten 03.06.2010. Me fonde te buxhetit te shtetit, ky projekt eshte planifikuar te zbatohet ne vitin 2022. Per shkak te kohes se gjate nga periudha e hartimit te projektit ka lindur e domosdoshme rishikimi i tij per arsye se gjate ketyre viteve eshte investuar ne pjese te veçanta edhe nga investitore te tjere.

Me urdher te Drejtorit te Pergjithshem te ARRSH Nr. 78, date 08.04.2022 eshte ngritur grupi i punes, i cili ka rishikuar projektin e ketij segmenti rrugor.

2- Propozimet nga Mbikëqyrësi i punimeve kane ardhur me date 27.01.2023. Pas propozimeve te ardhura nga Mbikëqyrësi i Punimeve, nga ARRSH jane ndjekur te gjitha hapat per vazhdimin e procedurave te metejshme. Me date 03.04.2023 Keshilli Teknik i ARRSH-se miratoi keto propozime mbi modifikimin dhe mosperputhjet e projekt-preventivit te ketij objekti. Referuar ketij vendimi, Mbikëqyrësi i punimeve dorezoi te gjithë dokumentacionin e nevojshem tekniko-ekonomik ne baze te se ciles u miratua edhe preventivi i rishikuar i ketij objekti.

Pas miratimit te preventivit, nga ARRSH nisen procedurat me ministrine e linjes per planifikimin e fondeve shtese, fonde, te cilat u miratuan me Planin Buxhetor te Investimeve te vitit 2024.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën Nr. 1707/3 prot, datë 18.03.2024 “Detajimi pjesor i buxhetit për shpenzimet kapitale për vitet 2024-2026...” ka miratuar këtë projekt, me detajimin përkatës. Financimi për vitin 2024 është 38,019,000 Lekë me TVSH.

Propozimet, të cilat janë shqyrtuar dhe miratuar nga Mbikëqyrësi i Punimeve, janë bërë për arsye të mëposhtme:

1. Ndryshime të volumeve për shkak të mospërputhjes së projektit me preventivin.
2. Ndryshime të volumeve dhe përmirësime për shkak të mospërputhjes së projektit me faktin në terren.

Bazuar në Ligjin Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Nenin 127, pika 1/b “Modifikim Kontrate” citohet:

“Kontrata publike apo marrëveshja kuadër mund të modifikohet pa zhvilluar një procedurë të re prokurimi në rastet e mëposhtme:

“b) për furnizimin e mallrave, shërbimeve apo kryerjen e punëve në një kontratë që është ende në zbatim nga kontraktori fillestar, të cilat janë bërë të domosdoshme dhe nuk janë përfshirë në dokumentet e tenderit për kontratën fillestare dhe kur zëvendësimi i kontraktorit fillestar:

i. nuk është i mundur për arsye ekonomike apo teknike, sikurse janë kërkesat për zëvendësimin apo ndërveprimin me pajisjen, shërbimet apo instalimet ekzistuese, të prokuruarat gjatë procedurës fillestare; si dhe

ii. do të shkaktonte vështirësi të mëdha apo rritje të konsiderueshme të kostove për autoritetin kontraktor.

si dhe Nenit 26 “Modifikimi i Kontratës”, të kontratës bazë, pikat:

26.1 Palët mund të modifikojnë kontratën gjatë afatit të saj, vetëm nëse ndodhen në ndonjë nga rastet e parashikuara në LPP.

26.2 Autoriteti/Enti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e mëposhtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- b) Korrigjime në materiale
- c) Korrigjime në sasi

26.3 Kur modifikimi shoqërohet me rritje të vlerës së Kontratës, vlera totale e modifikimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Kur kryhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të aplikohet për vlerën e përgjithshme të të gjitha modifikimeve. Kur kontrata përmban një klauzolë të rishikimit të çmimit, baza për përlllogaritjen e vlerës maksimale të lejuar për modifikimet do të jetë vlera e kontratës me çmimin e përditësuar.

26.4 Asnjë modifikim i Kontratës nuk do të bëhet pa miratimin paraprak të Autoritetit/Entin Kontraktor, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktorit dhe Autoritetit/Entin Kontraktor.

Argumentojmë se ndodhemi në kushtet e modifikimit të kontratës sipas parashikimit ligjor të sipërcituar.

Bazuar në pikën 6 të Nenit 127 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet:

“Arsyet dhe argumentimet për modifikimin e kontratës ose të marrëveshjes kuadër duhet të dokumentohen nga autoriteti ose enti kontraktor”; dhe

në pikën 7 të këtij neni “Në rastet e përmendura në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, dokumentimi i modifikimeve duhet të përmbajë një argumentim të të gjitha arsyeve se përse furnizimet, shërbimet ose punët janë të nevojshme, arsyet përse ato nuk janë mbuluar nga kontrata fillestare apo marrëveshja kuadër, si dhe arsyet ekonomike dhe teknike prej të cilave nuk mund të zëvendësohet kontraktuesi fillestar.

- ❖ Propozimet e Mbikëqyrësit, të cilat konsistojnë në përmirësimin e projektit pas shqyrtimit në Këshillin Teknik të ARRSH-së janë miratuar në parim me Vendimin e Këshillit Teknik Nr. 9, datë 03.04.2023. Referuar modifikimit të kësaj kontrate, rishikimi i projektit lind si nevojë gjatë zbatimit të projektit, në të cilat një nga detyrat e Mbikëqyrësit e mirëpërcaktuar në Termat e Referencës është, si më poshtë:

“Për çdo rast, që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në projektin dhe preventivin e parashikuar, Mbikëqyrësi i punimeve duhet t'i paraqesë ARRSH-së një relacion të plotë teknik (shoqëruar me skicat përkatëse), ku argumentohet ndryshimi. Ndryshimi në objekt (zbatimi i punimeve) do të bëhet vetëm pas miratimit nga ARRSH-ja”.

si dhe referuar Udhëzimit Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit”, Kreu I, pika 7.2 në të cilin citohet:

“Propozimet për rritjen e vlefës së kontratës dhe zgjatjen e afatit të punimeve i paraqiten investitorit, nëpërmjet mbikëqyrësit të punimeve, kur ato përmirësojnë treguesit e veprës, vijnë nga shkaqe pamundësisht të paparashikueshme, në kohën e duhur dhe nuk janë në kundërshtim me kushtet e kontratës”.

Më pas, miratimi nga ARRSH kryhet në parim nga Këshilli Teknik i Autoritetit Rrugor Shqiptar, i mbledhur nga Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH-së (Kryetar); drejtorë të drejtorive të ARRSH-së; dhe specialistë të fushës. Pas miratimit nga Këshilli Teknik i ARRSH-së, Mbikëqyrësi i punimeve dorëzon materialin e nënshkruar për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.

Propozimet janë bërë për arsytet e mëposhtme:

- 1- Ndryshim të volumeve për shkak të mospërputhjes së projektit me preventivin.
- 2- Ndryshime të volumeve për shkak të mospërputhjes së projektit me faktin në terren.

Konkretisht:

- Nga progresivi 0+000-8+550 (tek nënkalimi i rrugës Levan-Tepelenë) në projektin e tenderuar është parashikuar të realizohen vetëm veprat e artit (mure dhe tombino). Nga inspektimet në terren është konstatuar që veprat e artit (mure dhe tombino) janë në gjëndje të mirë funksionale, pasi është investuar dhe janë mirëmbajtur vazhdimisht nga ARRSH-ja. Edhe skarpatat e rrugës, në zonat ku janë parashikuar të realizohen disa mure pritës, janë në gjëndje të qëndrueshme dhe të mbushura me bimësi, kryesisht akacie dhe skarpatat janë të stabilizuara. Në këto kushte është propozuar që muret e parashikuara në projekt në këtë segment rrugor të mos ndërtohen dhe të mos ndërhyhet në skarpatat e rrugës.
- Në progresivin 13+400 në projektin e tenderuar është parashikuar realizimi i një rrethrotullimi me øjashtëm=24 m të spostuar në krahun e djathtë të rrugës duke realizuar lidhjen me rrugën kryesore të dy rrugëve sekondare. Duke qenë se projekti është realizuar disa vite më parë situata në terren në këtë zonë ka ndryshuar. Kjo zonë është zhvilluar me investime private në të dyja anët e rrugës dhe realizimi i këtij rrethrotullimi po has vështirësi sociale për shpronësimin e sipërfaqes që zë objekti që ndikojnë në realizimin në kohë të objektit. Gjithashtu në konfigurimin e kësaj nyje ka pikë konflikti të mjeteve që vijnë nga Vlora dhe duan të kthehen në rrugë dytësore. Në përshtatshmëri me gjendjen aktuale është propozuar që në vënd të këtij rrethrotullimi të realizohet një rrethrotullim në formë ovale-pikë loti (minirrethrotullim në zonë urbane në nivel) si dhe konfigurimi i nyjes.
- Në segmentin rrugor nga km 14+325.00 deri në km 14+875.00 (qendra e Novoselës) sipas projektit të tenderuar (relacionit teknik shtesë) do të realizohet shtresa e asfaltobetonit 4cm. Nga azhurnimi i kryer në terren në pjesën e parë (nga km 14+325-14+411), pra për një L=50m rruga është shumë e dëmtuar (gropëzime dhe në shtresën e binderit). Gjithashtu nga rillogaritjet e bëra nga sipërmarrësi i punimeve rezulton që edhe shtresa e tapetit nuk është e përfshirë në preventivin e kontratës. Për këtë segment propozohet që përveç shtresës së tapetit të parashikuar në projektin e tenderuar të realizohet në L=50 m edhe shtresa e binderit 6cm e bazuar sipas profilave TIP të projektit të tenderuar.
- Në segmentin rrugor nga km 16+275-16+725 (devijimi i urës së trenit), për të cilin projektuesi shprehet se do të realizohet me projekt të vecantë, përveç degradimit të shtresave asfaltike është konstatuar që kuota e rrugës është shumë më poshtë krahasuar me pjesën tjetër, rreth

1m. Për këtë është propozuar që të përmirësohet niveleta sipas profilit gjatësor duke rritur niveletën në rreth 80 cm dhe pjerrësia gjatësore shkon në -1.79% duke ruajtur të njëjtën trashësi të shtresave rrugore.

- Në segmentin rrugor nga prog. 27+300-28+030, për një gjatësi L=730 ml gjërësia e kurorës së trupit të rrugës nuk arrihet të bëhet 8.0 m për arsye të pemëve të ekualipteve që gjenden në dy anët e rrugës. Për këtë arsye propozohet të ruhet e pandryshuar gjërësia e korsive të lëvizjes dhe të ngushtohet gjërësia e bankinave me 25 cm në të dyja anët.

Në total:

Për realizimin e punimeve për përfundimin e punimeve të këtij objekti me ndryshimet e bëra vlera e këtij objektit është: 921,534,825 Lekë pa Tvsh

Vlera e punimeve sipas projektit të tenderuar: 792,055,225 Lekë pa Tvsh

Fondi rezervë: 23,069,550 Lekë pa Tvsh (përdorur)

Vlera e modifikimit të kontratës: 129,479,600 Lekë pa Tvsh

- Sqarojmë se vlera e punimeve jashtë kontrate e tejkalon disa herë vlerën e fondit rezervë, fond, i cili është ezauruar për pjesën e punimeve, të cilat janë realizuar në radhë teknologjike më përpara se të lindte nevoja për punimet jashtë kontrate.

Me Vendimin e Këshillit Teknik është vendosur:

Vlera e punimeve që mbeten jashtë vlerës së preventivit të kontratës së tenderuar prej: 129,479,600 Lekë pa TVSH të merren në preventivin me objekt: “Rehabilitimi i Segmentit Rrugor Fier - Vlorë (Rruga e Vjetër)” (Modifikim projekti).

Punimet e përfshira në preventivin “Rehabilitimi i Segmentit Rrugor Fier - Vlorë (Rruga e Vjetër)” (Modifikim projekti) janë domosdoshmëri të kryhen nga Kontraktori, aktualisht, për shkak të 3 arsyeve:

1. Ndërthurjes me punimet e kontratës bazë.

- Kontraktori “i ri” nuk mund të vazhdojë punimet me shtresat asfaltike, ndërkohë që nënshtresat janë ndërtuar nga kontraktori fillestar (kjo për shkak të garancisë së ndërtimit të këtyre nënshtresave).
- Moskoordinimi i grafikut të punimeve ndërmjet dy kontraktorëve të ndryshëm do të sillte zvarritjen e realizimit të punimeve brenda afatit të kontratave respektive, gjë që do të sillte rritje të kostove që vijnë nga mospërfundimi në afat, si dhe kostot e përdoruesve të rrugës.
- Duke marrë parasysh se në disa segmente, kontraktori duhet të beje tapet (shtresë asfalto-betoni), në gjatësi të ndryshme., ndërkohe që nuk është vendosur shtresa e binderit (mospërputhja e grafikëve të punimeve midis dy kontraktorëve).

2. Kostoja e ndërtimit

Nuk mundet kurrësesi që një operator të ofertojë më lirë se ai aktual, duke pasur parasysh:

- Rritja e çmimeve referuar “Manualit Teknik të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike” hyrë në fuqi në fillim të vitit 2024, krahasuar nga periudha e nënshkrimit të kontratës fillestare (referuar “Manualit Teknik të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të vitit 2015”).
- Vazhdimësia e kontratave të furnizimit që ka aktualisht kontraktori.
- Kosto shtesë që vijnë nga përsëritja e shpenzimeve për ngritjen e kantierit nga kontraktori “i ri”.
- Kostot shtesë për mobilizimin e stafit teknik drejtues të punimeve.

Nga sa më sipër, bazuar në Nenin 127 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, jemi në kushtet e modifikimit të kontratës sipas përcaktimit të këtij neni.

a) Autoriteti Kontraktor nuk mund të parashikonte mospërputhjet midis projektit-faktit-preventivit, si dhe nevojave dhe domosdoshmërisë së ndryshimeve në funksion të përdoruesve të rrugës.

b) Të gjitha modifikimet e kryera janë të nevojshme të kryhen në këtë fazë, pasi janë të lidhura ngushtësisht me ndërtimin e trupit kryesor të rrugës. Kryerja e punimeve në një fazë të dytë ose nga një tjetër kontraktor do të ishte teknikisht e pamundur, kryesisht, për ndërtimin e plotë të veprave të artit, sipas propozimeve të ardhura. Këtu mund të përmendim, përfundimin e plotë të shtresave asfaltike, përfundimin e plotë të veprave të artit; punimeve të gërmimit, etj. që është e pamundur të realizohen në një fazë të dytë, apo nga një OE tjetër. Sipas kërkesave të paraqitura nga palët e treta, realizimi i këtyre punimeve mund të kryhet vetëm nga kontraktori fillestar, pasi kemi të bëjmë me ndërthurje punimesh, ku nuk mund të punojnë dy kontraktorë të ndryshëm në të njëjtin kantier ndërtimi.

c) Kontrata shtesë nuk kalon 20% të vlerës së kontratës bazë. Autoriteti Kontraktor vlerëson se kostoja e përgjithshme e këtyre punimeve është më e vogël (16.34 %), pasi çmimet e preventivit të këtyre punimeve shtesë mbeten ato të tenderuara në kontratën bazë dhe të negociuara.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës / Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e punimeve

Gjate zbatimit të punimeve verëhet që volumet e punimeve nuk janë në përputhje me faktin dhe konkretisht:

- Në relacionin teknik shtesë të përgatitur thuhet se rruga është e gjatë 31.2 km nga të cilat 0.8km (rruga Aulona) dhe 9.5 km (nga hekurudha deri tek nenkalimi i rruges Levan- Tepelene) janë në gjendje të mirë dhe nuk do të nderhyet. Duke ju referuar vetëm relacionit teknik shtesë janë llogaritur volumet për zerat asfalt dhe binder, si me poshte:

$$31.2-0.8-9.5 = 20.9 \text{ km ose } 20.900 \text{ ml} \times 6.5\text{m} = 135.850 \text{ m}^2$$

Pra, minimalisht në preventiv për zerat asfalt dhe binder duhet të ishte sasia prej 135.850 m<sup>2</sup> pa përfshirë këtu asfaltin dhe binderin për kryqezime. Në preventivin e kontratës baze për këta dy zera janë parashikuar nga 117.421 m<sup>2</sup>.

Gjithashtu, gjatë zbatimit të punimeve vihen re demtime dhe cedime në trupin e rruges, të cilat kanë avancuar për shkak të trafikut të lartë dhe agjenteve atmosferike.

Konkretisht, është rritur gjerësia e pjesës së demtuar e cila ka qenë llogaritur me 175 cm në atë kohë, por në momentin e nderhyrjes, pjesa e demtuar ishte mesatarisht rreth 225 cm. Ky ndryshim nuk është reflektuar në preventivin e kontratës.

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: 129,479,600 Lekë, pa përfshirë vlerën e TVSH-së.

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): 921,534,825 Lekë, pa përfshirë vlerën e TVSH-së.

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: 12 muaj  
Dhe afati i ri (nëse është rasti): 15 muaj

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve ekonomik/ë:

Emri: “COBIAL”

NIPT: K02715414M

Adresa: TIRANE Rruga "Milto Tutulani", Nderresa nr.2, H. 19, ne Zonen Kadastrale Nr.8270,  
me

Nr. Pasurie 5/336-N16

Kontaktet: +355694052421

e-mail: info@cobial.al

15. Data e nënshkrimit të modifikimit: 16/07/2024

16. Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor: \_\_\_\_\_